



REPUBLIKA E KOSOVËS
 REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
 GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2019:134039
 Datë: 27.09.2021
 Numri i dokumentit: 00373087

C.nr.1021/17

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Burim Emërllahu, në çështjen kontestuese të paditësve A.A. ,nga Ferizaji Rr’’...’’ ,nr..., A.A.1. ,nga Ferizaji, Rr ’’...’’ ,nr..., L.S., e vajzërisë A., Z.A. nga Ferizaji , Rr. ’’...’’ , nr..., të cilët në bazë të autorizimit i përfaqëson avokati Kemajl Ademaj nga Ferizaji, A.A.2. ,nga Ferizaji, Rr ’’...’’ , nr..., të cilin në bazë të autorizimit e përfaqëson av. Xhevahire Kloppner ,nga Prishtina, kundër të paditurve B.A. nga Ferizaji, N.A. nga Ferizaji, N.A.1. nga Ferizaji, Rr’’...’’-objekti i parë banesor në krahun e majtë, E.A. ,nga Ferizaji rr’’...’’ ,me vendqendrim në Suedi, N.A.2. nga Ferizaji rr’’...’’ ,me vendqendrim në Belgjikë, ’’...’’ SH.P.K, me seli në Ferizaj, Rr’’...’’ të cilët në bazë të autorizimit i përfaqëson avokati Jeton Berisha ,nga Ferizaji, M.D. nga Ferizaji, F.A. nga Ferizaji, ,baza juridike: anulimi i kontratës ,vërtetimi i pronësisë, me datë 27.09.2021 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I.PJESËRISHTË APROVOHET SI E BAZUAR kërkesëpadia e paditësve A.A. nga Ferizaji Rr’’...’’ nr..., A.A. ,nga Ferizaji, Rr’’...’’ ,nr..., L.S. ,e vajzërisë A. ,Z.A. ,nga Ferizaji , Rr’’...’’ ,nr..., A.A. nga Ferizaji e parashtruar kundër të paditurve B.A. ,nga Ferizaji, N.A. nga Ferizaji, N.A.1. nga Ferizaji ,M.D., nga Ferizaji, N.A.2. nga Ferizaji, E.A., nga Ferizaji, F.A. nga Ferizaji, dhe vërtetohet se paditësit A.A. ,nga Ferizaji Rr’’...’’ nr..., A.A. ,nga Ferizaji, Rr’’...’’ ,nr..., L.S. ,e vajzërisë A. ,Z.A. ,nga Ferizaji , Rr’’...’’ ,nr..., A.A. nga Ferizaji janë bashkëpronarë secili prej tyre me nga 1/5 pjesë ideale të ngastrës kadastrale ... ,me sipërfaqe prej 205 m2 ,në vendin e quajtur ‘‘Lamët’’ Zona Kadastrale Ferizaj ,dhe detyrohen të paditurit B.A. ,nga Ferizaji, N.A. nga Ferizaji, N.A.1. nga Ferizaji ,M.D., nga Ferizaji, N.A.2. nga Ferizaji, E.A., nga Ferizaji, F.A. nga Ferizaji që

paditësve të ua njohin të drejtën e bashkëpronësisë në ngastrën kadastrale ... ,me sipërfaqe prej 205 m² ,në vendin e quajtur ‘‘Lamët’’Zona Kadastrale Ferizaj dhe të mos pengojnë regjistrimin e të njëjtës së drejtë në emër të paditësve në regjistrin kadastral në të kundërtën ky aktgjykim do tu shërbej paditësve si dokument për regjistrimin e së drejtës së bashkëpronësisë për ngastrën ... ,me sipërfaqe prej 205 m² ,në vendin e quajtur ‘‘Lamët’’Zona Kadastrale Ferizaj,në regjistrin kadastral .

II.Refuzohet si e pa bazuar pjesa e kërkesëpadis së paditësve A.A. nga Ferizaji Rr’’...’’ nr..., A.A. ,nga Ferizaji, Rr’’...’’ ,nr..., L.S. ,e vajzërisë A. ,Z.A. ,nga Ferizaji , Rr’’...’’ ,nr..., A.A. nga Ferizaji e parashtruar kundër të paditurve B.A. ,nga Ferizaji,N.A. nga Ferizaji, N.A.1. nga Ferizaji ,M.D., nga Ferizaji, N.A.2. nga Ferizaji, E.A., nga Ferizaji, F.A. nga Ferizaji, me të cilën kanë kërkuar : të vërtetohet se paditësit A.A. nga Ferizaji Rr’’...’’ nr..., A.A. ,nga Ferizaji, Rr’’...’’ ,nr..., L.S. ,e vajzërisë A. ,Z.A. ,nga Ferizaji , Rr’’...’’ ,nr..., A.A. nga Ferizaji të gjithë bashkarishtë e kanë fituar të drejtën e pronësisë në ½ pjesë ideale [secili në pjesën ideale prej 1/10 të sajë]të ngastrës kadastrale P-... në sipërfaqe prej 306 m² ,ZK Ferizaj e cila pas bashkimit edhe me shumë ngastra tjera është bërë pjesë e ngastrës kadastrale nr.... ZK Ferizaj ,e regjistruar në emër të të paditurës ‘...’, të anulohet kontrata për bashkëinvestim :LRP.nr.9581/2017 ,nr.Ref.nr.3550/2017 në pjesën e cila ka të bëjë me pjesën ideale prej ½ të ngastrës kadastrale P-... në sipërfaqe prej 306 m² ZK Ferizaj.

Kurse sipërfaqja e sipër përmendur prej 306 m² që tani është pjesë e ngatstrës kadastrale nr.... ZK Ferizaj ka këto kufi dhe përmasa: në anën veriore kufizohet me parcelën ... në gjatësi prej 29.20 metra ,në anën lindore kufizohet me rrugën publike ‘...’,në gjatësi prej 11.23 metra,në anën jugore kufizohet me parcelën ... në gjatësi prej 25.02 metra,dhe në anën përendimre në gjatësi prej 11.06 metra kufizohet me parcelën

III.Secila nga palët B.A. ,nga Ferizaji,N.A. nga Ferizaji, N.A.1. nga Ferizaji ,M.D., nga Ferizaji, N.A.2. nga Ferizaji, E.A., nga Ferizaji, F.A. nga Ferizaji i bartë shpenzimet e veta të procedurës kontestimore.

IV.Detyrohen paditësit A.A. nga Ferizaji Rr’’...’’ nr..., A.A. ,nga Ferizaji, Rr’’...’’ ,nr..., L.S. ,e vajzërisë A. ,Z.A. ,nga Ferizaji , Rr’’...’’ ,nr..., A.A. nga Ferizaji që të paditurës ‘...’ SH.P.K,me seli në Ferizaj në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore tia paguajnë shumat siq vijon:për 11 seanca gjyqësore shumë prej 2974.4 euro,për parashtrësën e datës 19.12.2017 shumë prej 208 euro.

V. Shpenzimet e procedurës të cilat paditësit A.A. nga Ferizaji Rr’’...’’ nr..., A.A. ,nga Ferizaji, Rr’’...’’ ,nr..., L.S. ,e vajzërisë A. ,Z.A. ,nga Ferizaji , Rr’’...’’ ,nr..., A.A. nga Ferizaji i kanë bërë në raport me të paditurit B.A. ,nga Ferizaji,N.A. nga Ferizaji, N.A.1. nga Ferizaji ,M.D., nga Ferizaji, N.A.2. nga Ferizaji, E.A., nga Ferizaji, F.A. nga Ferizaji secila nga palët paditëse i bartë të vetat .

VI.Detyrohen paditësit A.A. nga Ferizaji Rr’’...’’ nr..., A.A. ,nga Ferizaji, Rr’’...’’ ,nr..., L.S. ,e vajzërisë A. ,Z.A. ,nga Ferizaji , Rr’’...’’ ,nr..., A.A. nga Ferizaji që kësaj gjykate në emër të shtesës

së taksës gjyqësore për padi tia paguajnë shumën prej 70 euro ,në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Paditësit A.A., A.A.1., L.S.A., përmes të autorizuarit të tyre avokatit Kemajl Ademaj nga Ferizaji, kanë parashtruar padi në këtë gjykatë ,kundër të paditurve B.A., N.A., N.A.1., me adresë të vendbanimit Rr”...”-objekti i parë banesorë në krahun e majtë, “...” SH.P.K, me seli në Ferizaj, me bazë juridike vërtetimi i pronësisë ,me të cilën kanë kërkuar që të vërtetohet se paditësit e kanë fituar të drejtën e pronësisë në pjesën ideale prej ½ të ngastrës kadastrale P-... ,në sipërfaqe prej 556 m2 në Zonën Kadastrale në Ferizaj, mbi bazën e trashëgimis, si dhe të detyrohen të paditurit që paditësve të ja njohin të drejtën e bashkëpronësisë në ngastrën kadastrale P-... ,në sipërfaqe prej 556 m2 në Zonën Kadastrale në Ferizaj dhe të njejtit të mos i pengojnë në regjistrimin e sajë në emër të paditësve si bashkëpronarë ,në të kundërtën paditësve ky aktgjykim do të ju shërbej si dokument intabulimi për regjistrimin e paluejtshmërisë në emër të tyre si bashkëpronarë si dhe të ua kompensojnë paditësve të gjitha shpenzimet e procedurës kontestimore.

Me parashtrësë të dorëzuar në këtë gjykatë me datë 11.05.2018 paditësve të sipër përmendur ju kanë bashkangjitur edhe paditësit Z.A. dhe A.A.2.

Paditësit A.A., A.A.1., L.S.A., Z.A. dhe A.A.2. në lidhje me qështjen kontestuese përmes të autorizuarve të tyre av. Kemajl Ademaj dhe av. Xhevahire Kloppner ,nga Prishtina kanë theksuar : me të paditurit B.A., N.A., N.A.1. janë në raporte familjare ,kusherinjë të parë ,përkatësishtë paditësit janë trashëgimtarë ligjorë të H.A., kurse të paditurit janë trashëgimtarë të H.A.1. ,kurse H.A. dhe H.A.1. të dy janë djemt e R.A. tani i njerë.

Babai i paditësve H.A. ka vdekur në vitin 1983 .Kurse parcela kadastrale ... ,me sipërfaqe prej 556 m2 ZK Ferizaj ka qenë parcela ku gjyshi i paditësve dhe i të paditurve B.A., N.A., N.A.1., ka pasur shtëpinë dhe kjo parcelë ka qenë e regjistruar në emër të tijë.

Pas vdekjes së babait të paditësve ,paditësit pas një kohe të shkurtër për shkak të kushteve të vështira ekonomike së bashku me nënën e tyre ishin vendosur në Gjermani .Pasi që paditësit me nënën e tyre kishin shkuar në Gjermani ,pas disa kohësh kishte vdekur R.A. ,gjyshi i paditësve dhe i të paditurve B.A., N.A., N.A.1. Derisa ishte gjallë gjyshi i palëve ndërgjyqëse ,çdo herë ishte deklaruar se gjysma e oborrit është e fëmijëve të H., përkatësishtë e tani paditësve.

Tani paditësit kanë kuptuar se tani të paditurit B.A., N.A., N.A.1. kanë lidhur një kontratë për bashkëinvestim me të paditurën “...” SH.P.K, me seli në Ferizaj, sipas së cilës të paditurit B.A., N.A., N.A.1. si bashkëpronarë të ngastrës kadastrale të sipër përmendur më lartë kanë bashkuar parcelën e

përmendur me parcela tjera dhe si rrjedhojë tani kanë regjistruar parcelën ,përkatësishtë ngastrën kadastrale P-... ZK Ferizaj me sipërfaqe të përgjithshme prej 2077 m² në emër të ‘...’ SH.P.K.

Me datë 21.05.1993 është shqyrtuar pasuria trashëgimore e të ndjerit R.A., përmes aktvendimit T.nr.37/93 të të njejtës datë ,kurse paditësit nuk kishin marrë pjesë ,kjo pasi që në momentin e shqyrtimit të kësaj trashëgimie paditësit ishin të mitur dhe jetonin në Gjermani ,kurse në dëshmi vdekjen e datës 28.04.1993 ,me keqëbesim nuk ishin përmendur emrat e tyre.Në fakt pjesëmarrësit në seancën për shqyrtimin e trashëgimisë së sipër përmendur ,me keqbesim ishin deklaruar se në momentin e shqyrtimit të trashëgimisë nuk kishte trashëgimtarë tjerë përpos atyre që ishin shënuar në aktvdekje edhe pse pa mëdyshje ata e dinin se vëllau i tyre [bashkëshorti përkatësishtë prindi paditësve]H.A. i cili kishte vdekur me datë 04.10.1983 kishte trashëgimtar të tijë tani paditësit emrat e të cilëve do të duhej të ishin lajmëruar në aktvdekje si dhe procesverbalin e hartuar me rastin e mbajtjes së seancës për shqyrtimin e trashëgimis së përmendur.Si dhe rrjedhojë paraardhësi i të paditurve padrejtësishtë dhe në kundërshtim me ligjin dhe gjendjen faktike ishte shpallur trashëgimtarë i vetëm në të gjithë masën trashëgimore të lënë nga babai i tij [gjyshi tani paditësve],e që përbëhej edhe nga ngastra kadastrale 1894 ZK Ferizaj.

Paditësit kanë kuptuar se të paditurit B.A. ,nga Ferizaji, N.A. nga Ferizaji, N.A.1. nga Ferizaji në bazë të aktvendimit të trashëgimisë nr.181/01,i datës 20.08.2017 të Gjykatës Komunale në Ferizaj ishin shpallur trashëgimtar se cili në pjesën ideale prej 1/3 në ngastrën kadastrale P-..., në sipërfaqe prej 556 m² ZK Ferizaj ,përkatësishtë në oborrin dhe shtëpin e përmendur më parë.

Si rrjedhojë e gjithë kësaj ,tani paditësit e kan kuptuar se ata në mënyrë të kundërligjshme ishin privuar nga e drejta e trashëgimis në ngastrën e përmendur kadastrale ,prandaj nga gjykata kërkojnë që të ju njihet e drejta e pronësisë në pjesën ideale prej 1/2 të ngastrës kadastrale P-..., në sipërfaqen prej 556 m² ZK Ferizaj e cila u sqaruar më lartë tani është bashkuar me ngastrat tjera dhe është në kuadër të ngastrës kadastrale P-... ZK Ferizaj me sipërfaqe prej 2077 në emër të ‘...’ SH.P.K –të paditurit të katërt.

Baza ligjore e padisë së paditësve qëndron: në nenin 20 të Ligjit për Mardhënjet Themelore Juridike Pronësore.Nenin 37 të Ligjit për Mardhënjet Themelore Juridike Pronësore.

Nga veprimet e të paditurve B.A. nga Ferizaji, N.A. nga Ferizaji, N.A.1. nga Ferizaji të shpjeguara si më lartë si dhe paraardhësve të tyre ,si dhe duke shfrytëzuar mos prezencën e paditësve si dhe rrethanat tjera faktike ,me keqbesim dhe në mënyrë të kundërligjshme i kanë privuar paditësit nga e drejta e tyre për fitimin e të drejtës së pronësisë në ngastrën P-..., me sipërfaqe prej 556 m² ZK Ferizaj.

I padituri N.A.1., me datë 18.12.2017 kishte parashtruar përgjegjje në padi me të cilën e kishte kundërshtuar në të tërësi kërkesëpadin e paditësve duke u bazuar në theksimet e tij: paditësit nuk kanë parashtruar asnjë provë apo fakt me të cilat do të arsyetonin pretendimin e tyre në lidhje me fitimin e pronësisë për ngastrën kadastrale P-... , në sipërfaqe prej 552 m² në Zonën Kadastrale në Ferizaj. Babai i paditësve H.A. dhe babai i të paditurve H.A.1. kanë jetuar në një bashkësi familjare gjerë në vitin 1975-76 dhe në të njëjtin vit e kanë shpëputur bashkësinë familjare dhe se babai paditësve pas shpëputjes së bashkësisë familjare të sipër përmendur është vendosur në një banesë së bashku me familjen e tij, kurse babai i të paditurve në tokën kontestuese të sipër përmendur ka ndërtuar shtëpinë dy kateshe e gjysmë në të cilën ka jetuar me familjen e tij të ngushtë nga ajo kohë e deri në vdekje, kurse pas vdekjes së tij të njëjtën shtëpi e kanë pasur në posedim dhe shfrytëzim i padituri parë, i dyti dhe i treti. Babai i të paditurve ka vdekur më datë 25.12.1996 dhe në bazë të aktvendimit të trashëgimisë T.nr.181/01 të datës 26.07.2007 të lëshuar nga Gjykata Komunale në Ferizaj trashëgimtar të të ndjerit H.A.1. janë shpallur djemt e tij N.A.1., N.A., B.A. edhe atë me nga 1/3 pjesë ideale të paluejtshmërisë kontestuese dhe ndryshimet në fjalë janë regjistruar edhe në regjistrin kadastral dhe të njëjtit kanë qenë në posedim të paluejtshmërisë në fjalë, kurse tani paditësit asnjëherë nuk kanë qenë në posedim, në shfrytëzim dhe në pronësi të tokës kontestuese. Kërkesëpadia e paditësve me të cilën kanë kërkuar që të vërtetohet e drejta e pronësisë në bazë të trashëgimisë është parashtruar edhe atë në bazë të nenit 138 të Ligjit mbi Trashëgimin me nr.2004/26, të datës 28 Korrik 2004 e që në rastin konkret nga vdekja e H.A.1. kanë kaluar me tepër se 20 vite. Të paditurit të drejtën e pronësisë për paluejtshmerin kontestuese e kanë fituar edhe në bazë të nenit 40 paragrafi 2 të Ligjit për Pronësin dhe të Drejtat Tjera Sendore. Të paditurit kanë lidhur Kontratë mbi Bartjen e Paluejtshmërisë me bashkëinvestim me të paditurën "...” me seli në Ferizaj e cila kontratë është vërtetuar te noteri Selatin Shahini LRP.nr.9581/2017 dhe REF nr.3550/17.

Përfaqësuesi i të paditurve Avokati Jeton Berisha nga Ferizaji në lidhje me qështjen kontestuese ka deklaruar:

Gjatë gjithë rrjedhës së këtij shqyrtimi gjyqësor, në mënyrë të vazhdueshme kundërshtimet tona kanë qenë të karakterit formal, faktik dhe material.

Si të meta të karakterit formal të padisë dhe kërkesë padisë së paditësve, e që e drejta materiale kërkon plotësimin e kushteve ligjore e të cilat gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor, janë vërtetuar për të mos thënë kanë qenë jo kontestuese, janë fakte si në vijim: fakti se para ardhësi i paditësve ka vdekur në vitin 1983, fakti se i ndjeri gjyshi i ndërgjyqëve R.A., ka vdekur në vitin 1986, fakti se bashkësia familjare ndërmjet para ardhësit të paditësve, dhe para ardhësi të të paditurve, është ndarë në vitin 1975, në kohën kur ishin të gjallë të gjithë të para ardhësit duke përfshir edhe gjyshin e tyre R.A.. Nëse i referohemi bazës juridike të kërkesë padisë, neni 20 të cilit me padi iu kishte referuar, nga koha e vdekjes, përkatësisht ndarjes së bashkësisë familjare deri në ushtrimin të padisë kanë kaluar edhe atë, 34 vite, nga koha e vdekjes, së H.A., (para ardhësi i paditësve), 31 vite,

nga koha e vdekjes së gjyshit të ndërgjyqëve, ndërsa nga koha e ndarjes së bashkësisë familjare kanë kaluar 42 vite.

Ligji i trashëgimisës Kosovës me nenin 138 e ka parashikuar afatin brenda të cilit trashëgimtarët kanë të drejt të kërkojnë mbrojtje juridike gjyqësore, e i cili afat është përcaktuar, afati 10 vjeçar, e nëse i referohemi kësaj dispozite ky afat ka kaluar për 3-4 fish, nga afati që parashihet me ligj.

Në shkresat e lëndës, si dhe në ekspertizën gjeodezike është konfirmuar se prona përkatësisht pjesa e pronës të cilën paditësit e kanë kërkuar me anë të padisë, me aktvendimin e trashëgimisë T.nr. 181/01 më datë 20.06.2007 ka kaluar në emër të të paditurëve N.1., N. dhe B.A. dhe nga koha e nxjerrjes së këtij vendimit (20.06.2007, deri në datën e ushtrimit të padisë, (10.11.2017), kanë kaluar, 10 vite, 5 muaj, e dhjet ditë, ndërsa është e ditur botërisht se me regjistrim personi apo personat që në regjistrat kadastrat evidentohen për më shumë se 10 vite e fitojnë të drejtën, nëse gjatë kësaj kohës, nuk është paraqitur ndonjë kundërshtim.

Siq u përshkruar më lartë nga data e vdekjes së të ndjerit H. (1983) dhe të ndjerit Ramadan (1986), kanë kaluar vitet e nevojshme që edhe mos ekzistonin të metat formale për sa i përket parashkrimit të kërkesave ndaj të paditurëve, edhe nën supozimin se të paditurit, e tjerë, përjashtuar "...” ishin me keqe besim të njëjtit sipas legjislacionit në fuqi, tani dhe legjislacionin në fuqi, në kohën e vdekjes, pas ardhësit juridik e fitojnë statusin, e poseduesit me mirëbesim nga dita e vdekjes së para ardhësit, e që në rastin konkret po thuajshe të gjithë, para ardhësit kanë vdekur 30 e më tepër vite, e që nën kupton se të paditurit edhe sikur ekzistonte keqe besimi i pretenduar, të paktën për 30 vite kanë qenë posedues me mirë besim, dhe pretendimet e paditësve, dhe përfaqësuesve të tyre, se kinse të paditurit, janë posedues me keqe besim, se kinse të paditurit kanë bërë shkelje, janë pretendime bosh, e janë pretendime sikur të vdekurit, para ardhësit e tyre, të ishin gjallë do të neveriteshin, nga këto fjalë. „sepse të gjithë dëshmimtarët, dhe të gjitha palët në kontest përjashtuar të paditurën "...” në këtë sallë gjykimi në prezencën tonë, një zëri kanë deklaruar, se raportet ndërmjet babait R. dhe të bijëve të tij H. dhe H.A.1., kanë qenë raporte të shkëlqyeshme, të njëjtat raporte janë kultivuar edhe ndërmjet vëllezërve H. dhe H.1., por interesat puro materiale dhe atë vetëm pas marrjes së informatave se të paditurit, e kanë dhënë shtëpinë e tyre të cilën e posedonin nga para ardhësit e tyre për ndërtim kishin shprehur ambiciet e tyre, për gjoja shkeljet që ishin bërë, vetëm e vetëm për ta nxjerrë ndonjë njësi banesore përmes presionit që mund të iu bënin të paditurve.

Gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor, jemi dëshmitar, se paditësit përmes vrazhdësisë kanë tentuar që secilin dëshmitar e po thuajse të gjithë ishin fqinjë, kushëri, apo halla i ofendonin me shprehjet “po rren”, e me presione të tjera, për të cilat presione edhe vet ishin dëshmitar.

Si fakte që LPK, i konsideron si të provuar janë faktet të cilat i pohojn vetë palët. Në këtë shqyrtim gjyqësor, po thuajse të gjithë paditësit, në veçanti, paditësja, Z.A., e ka pohuar faktin se nga

viti 1983 kur kanë hyrë në banesën e marrë nga Enti i sigurimeve, e deri në ushtrimin e kësaj padie, asnjë herë, nuk e kanë poseduar, apo bashkë poseduar, shtëpinë, e vjetër, të cilën tani e posedojnë të paditurit përjashtuar “...”.

Ligji LPK-së, si shkelje esenciale procedurale e konsideron aktgjykimin i cili ka vendosur për kërkesat që janë parashtruar pas afatit ligjor apo më saktësisht për kërkesat e parashtruara, në rastin konkret gjykatës i propozojmë para se ti vlerësoj pretendimet faktike dhe materiale, të palës paditëse, ta shqyrton afatshmërinë, e kërkesave dhe të njëjtat pa shqyrtim të fakteve, ta hudhë, si të pa lejuar.

Për sa i përket të paditurës “...”, siq e kemi thënë në përgjigje në padi, të njëjtës, nga fillimi i ka munguar legjitimiteti real dhe procedural pasive, për këtë arsye gjykatës i propozojmë që edhe ndaj kësaj të paditure, padia dhe kërkesë padia e paditësve të hudhet si e pa lejueshme për shkak të mungesës së legjitimitetit pasiv.

I kërkoj shpenzime e procedures për seanca, për secilën seancë të mbajtur, seancat e shtyera, pa fajin e të paditurëve, kompensimin për tri përgjigje në padi duke pasur për bazë faktin se zgjerimi i padisë, ka ndodhur në faza të ndryshme, eventualisht me ndonjë parashtres të ndryshme.

Të padituri M.D., N.A.2., F.A. në përgjegjjen në padi të parashtruar në këtë gjykatë me datë 19.07.2019 kanë theksuar: H. dhe H.A.1. janë bijtë e R.A., H. dhe H.A.1. deri në vitin 1975 kanë jetuar në bashkësi familjare dhe kryefamiljarë ka qenë gjyshi R.A.. Ndërsa ndarja e bashkësisë familjare është bërë sipas traditësi dhe adeteve dhe procedura ligjore. R.A. sa ishte gjallë e kishte bërë ndarjen e bashkësisë së sipër përmendur familjare rrjellimisht edhe të pronave të paluejtshme. Paraardhësit të paditësve H.A. pas ndarjes së bashkësisë familjare i kishte takuar parcela ... ZK Ferizaj si dhe një banesë, të cilën Enti i Sigurimit ia kishte dhënë në shrytëzim H.A., në kohën gjersa ky ishte në bashkësi familjare, ndërsa babait tonë H.A. i kishte takuar shtëpia e vjetër e cila ishte ndërtuar në ngastrën ... ZK Ferizaj. Pas ndarjes së bashkësisë familjare prindërit kishin shkuar për të jetuar me babain tonë H.A.1. me të cilin kishin jetuar deri në vdekje. Nga viti 1975 ,kur është ndarë bashkësia familjare ,H.A. dhe familja e tij tani të paditurit kanë banuar në banesën e tyre ,ndërsa pas luftës diku në vitin 2003 paditësit kanë ndërtuar edhe një shtëpi në parcelën ... ZK Ferizaj ,parcelë kjo e dhuruar nga gjyshi jonë R.A.. Po ashtu edhe babai jonë H.A.1. së bashku me pasardhësit e tij dhe prindërit e tij nga viti 1975 kur është ndarë bashkësia familjare e derisa ka vdekur ka jetuar në shtëpin e vjetër e cila ka qenë e ndërtuar në ngastrën ... ZK Ferizaj. Vlen të theksohet se as gjatë kohës sa paraardhësit tanë[gjyshi R.A., babai H.A.1., axha H.A. dhe pas vdekjes së tyre as një herë nuk kemi pas probleme por as pretendime pronësore as nga ana jonë ndaj pasurisë së tyre dhe as ata ndaj pronës sonë ,deri në kohën kur të paditurit si pronarë legjitim njësinë kadastrale me numër ... ZK Ferizaj kanë filluar ndërtimin e një objekti banesor[në cilësinë e bashkëinvestuesit]. Andaj propozojmë që të refuzohet padia dhe kërkesëpadia e paditësve ,për vërtetimin e pronësisë në bazë të trashëgimisë si e pa bazuar.

Me qëllim të vërtetimit sa më të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë qështje civilo juridike janë administruar si provë:aktvendimi i trashëgimisë, me nr. T.nr.37/93,i datës 21.05.1993,dëshmia vdekja e datës 03.05.2018, në emër të të ndjerit H.A., e lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile në Ferizaj,certifikata e vdekjes në emër të H.A., i datës 02.05.2018,nr.180,e lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile në Ferizaj,ekstrakti nga Regjistrit Qendror i Gjendjes Civile i dates 02.05.2018, i lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile në Ferizaj, në emër të Z.A., historiat i datës 20.02.2018, me nr. 14541/18 i lëshuar nga Zyra kadastrale në Ferizaj,për ngastrat kadastrale ... dhe ...ZK Ferizaj, aktvendimi i trashëgimisë T.nr. 181/01 i dt. 20.06.2007, Gjykatës Komunale në Ferizaj, certifikata pronësore e dt. 08.11.2017, në emër të H.A., e lëshuar nga Zyra Kadastrale Komunale në Ferizaji,mendimi dhe konstatimi i ekspertit gjeometër M.L., i dt. 20.02.2018, së bashku me dokumentet përcjellëse , fotografit, certifikata pronësore, historiat, aktvdekja e dt. 28.04.1993,e hartuar pas vdekjes së R.A., aktvendimi i dt. 27.04.1993,me numër 203-11,i lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Serbisë-Sekretariati për punë të Brendshme, fleta poseduese nr. 148 dhe 197 ZK Ferizaj,procesverbali i dt. 20.05.1993 për shqyrtimin e trashëgimisë me nr.37/93,është dëgjuar në cilësi të palës Z.A.,janë dëgjuar në cilësi të dëshmitarëve:F.A.1., me numër personal të letërnjoftimit ..., A.N. nga Shkupi Republika e Maqedonisë së Veriut-Lagjja Aerodrom,me numër personal ..., B.M. nga Ferizaji „Rr’’...’’,nr..., me numër personal ..., S.A., nga Ferizaji „rr’’...’’-banesa e ..., me numër personal ..., N.H. nga Shtimja ,me numër personal ..., S.A.1., me numër personal ..., R.M. me numër personal të letërnjoftimit ..., N.A.3. me numër personal të letërnjoftimit ..., si dhe janë lexuar deklaratat e dëshmitarëve dhe paditëses Z.A. ,në seancën e datës 18.05.2021.

Gjykata provat e administruara i ka vlerësuar sipas nenit 8 të LPK-së dhe ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Me leximin e aktvdekjes së datës 03.05.2018 e lëshuar nga Zyra e Regjistrimit Civil –Ofiqaria në Ferizaj ,gjykata ka vërtetuar se H.A.,nga babai R. ka lindur me datë ..., kurse ka vdekur me datë 04.10.1983 dhe pas vdekjes ka lënë trashëgimtarët Z.A. e lindur K., A.A., L.S.A., A.A.1., A.A.2.

Me Leximin e certifikatës së vdekjes ,e datës 02.05.2018 ,e lëshuar nga nga Zyra e Regjistrimit Civil –Ofiqaria në Ferizaj gjykata ka vërtetuar se H.A. ka lindur me datë ..., kurse ka vdekur me datë 04.10.1983 dhe ishte i lindur nga babai R. dhe nëna A.A.3., kurse bashkëshorte e tij ishte Z.A.

Me leximin e ekstraktit të lindjes , i datës 02.05.2018 ,gjykata ka vërtetuar se Z.A. është e lindur me datë ... nga babai Xh.K. dhe nëna R.K..

Me leximin e aktvendimit për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore ,me numër T.nr.181/01,i datës 20.06.2007 gjykata ka vërtetuar se këtë aktvendim është shqyrtuar pasuria trashëgimore e të

ndjerit H.A.1. nga babai R. ish nga Ferizaji ,i lindur me datë ... , i cili ka vdekur 25.12.1996 dhe me këtë aktvendim trashëgimtar të ngastrës kadastrale ... ,në vendin e quajtur ‘...’, me sipërfaqe prej 03,92 ari ishin shpallur N.A., B.A., N.A.1. në 1/3 pjesë ideale të sajë të gjithë atëherë me adresë në rrugën ‘...’ në Ferizaj. Kurse nuk ishin shpallur trashëgimtar trashëgimtarët tjerë të të njejtit M.D., N.A.2., E.A. dhe F.A. pasi që nuk kishin pranuar pjesët e trashëgimisë.

Me leximin e certifikatës e datës 08.11.2017, me numër 22-43990,e lëshuar nga Zyra Kadastrale Komunale në Ferizaj ,gjkata ka vërtetuar se paluejtshmëria kontestuese gjegjësishtë ngastra kadastrale nr. ... ,në vendin e quajtur lamët,evidentohet në regjistrin kadastrale në emër të H.A.1. nga babai R. ,Rr’ ...’,nr...

Nga deklarata e paditëses Z.A. gjykat ka vërtetuar se e njehta nuk ka jetuar në tokën kontestuese gjegjësishtë ngastrën kadastrale të shënuar në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi qe 44 vite .Kurse në posedim të ngastrës kadastrale të shënuar në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi ka qenë H.A.1. më shumë se 40 vite pa u penguar nga askush.Po ashtu edhe fëmijët e H.A.1. kanë qenë në posedim të ngastrën kadastrale të shënuar në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi më shumë se 40 vite pa u penguar nga askush.Paditësit asnjëherë nuk kanë parashtruar padi në lidhje ngastrës kadastrale të shënuar në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi përpos padis për të cilën po zhvillohet kontesti.

Gjykata nuk ia ka falur besimin deklaratës së paditëses Z.A., përmes së cilës ka theksuar se H.A.1. si kompensim për paluejtshmërin si në pikën I ka marrë shpërblim nga H.A. një veturë Fiat të Zi ,sepse ky fakt nuk vërtetohet me asnjë provë ,kurse nga deklaratat e dëshmitarëve të dëgjuar vërtetohet se H. e ka fituar tokën kontestuese në atë mënyrë që me rastin e ndarjes së bashkësisë familjare ia ka dhënë babai tij R.A..

Nga konstatimi dhe mendimi i ekspertit gjeodet M.L., i datës 20.02.2018 dhe dëgjimi i të njejtit ekspert në seancë gjyqësore gjykata ka vërtetuar :

Ngastra kadastrale nr... ZK Ferizaj ,me sipërfaqe prej 205 m2,me kulturë oborrë dhe shtëpi-ndërtesë evidentohet në emë të H.A. nga babai R. dhe ka këto kufi dhe përmasa ,në anën veriore është e kufizuar me parcelën ..., në anën lindore është e kufizuar me rrugën publike ‘...’,në anën jugore është e kufizuar me parcelën ... dhe në anën përendimore është e kufizuar me parcelat ... dhe

Në parcelën kadastrale nr. ... ZK Ferizaj ka të ndërtuar një shtëpi P+1 e cila shfrytëzohet nga paditësit .

Ngastra kadastrale nr.... ZK Ferizaj kishte këto kufi dhe përmasa në anën veriore kufizohet me parcelën ..., në anën lindore kufizohet me rrugën publike "...", në anën jugore kufizohet me parcelën ... dhe në anën përendimore kufizohet me parcelën ...

Në parcelën kadastrale ... në kohën e daljes në vendin e ngjarjes nuk kishte të ndërtuar ndonjë objekt ,por ishte tokë e punuar edhe mbushur me dhe.

Ndërsa për parcelën kadastrale ... ishte shqyrtuar trashëgimia e të ndjerit R.A., me aktvendimin T.nr.37/93 ,të datës 21.05.1993 të Gjykatës Komunale në Ferizaj dhe e njejta pronë ka kaluar nga R.A. te H.A. 1/1,kurse e njejta parcel me aktvendimin T.nr.181/01 i datës 20.06.2007 ka kaluar nga H.A.1. në emër të B., N. dhe N.A.1. ,me nga 1/3 pjesë ideale.

Kurse në bazë të kontratës për bartjen e paluejtshmërive dhe bashkëinvestim në ndërtim të objektit banesor –afarist me numër LRP.nr.9581/2017 dhe ref 3550/2017 .deklaratën nr.10-463-745,të datës 19.10.2017 dhe nr.10-463-74 të datës 23.10.2017 iu ka bashkuar parcelës ... ZK Ferizaj dhe ka kaluar në emër të "...” SHPK.

Sipërfaqja prej 306 m² e cila gjindej në kuadër të ngastrës kadastrale ... ZK Ferizaj e, cila parcel i ishte bashkuar parcelës ... e që më pastaj janë bashkuar edhe disa parcela dhe kan marrur numrin ... ZK Ferizaj dhe evidentohet në emër të "...”.

Sipërfaqja e sipër përmendur prej 306 m² që është pjesë e ngastrës kadastrale ... ZK Ferizaj ka këto kufi dhe përmasa :në anën veriore kufizohet me parcelën ... në gjatësi prej 29.20 metra ,në anën lindore kufizohet me rrugën publike "...",në gjatësi prej 11.23 metra,në anën jugore kufizohet me parcelën ... në gjatësi prej 25.02 metra,dhe në anën përendimore në gjatësi prej 11.06 metra kufizohet me parcelën ...

Me një parashtrësë të dorëzuar në këtë gjykatë me datë 17.05.2019 ,përfaqësuesi i paditësve av.Kemajl Ademaj e ka zgjeruar padin në aspektin subjektiv duke përfshir në cilësi të të paditurëve edhe M.D., N.A.1., E.A. dhe F.A. nga Ferizaji.

Me dëgjimin e dëshmitarit F.A.1. gjykata ka vërtetuar se H.A. dhe H.A.1. kanë jetuar në bashkësi familjare dhe të njejtit pastaj e kanë ndarë bashkësinë familjare nga njëri tjetri dhe me rastin e ndarjes së kësaj bashkësie familjare kanë arritur marrëveshje që paluejtshmëria si në pikën II të dispozitivit ti takoj H.A.1., në të cilën ka qenë e ndërtuar një shtëpi. H.A.1. në shtëpin e sipër përmendur ka jetuar deri në vdekje ,së bashku me familjen e tij të ngusht fëmijët.Po me të njejtin në atë shtëpi pas ndarjes së bashkësisë familjare të sipër përmendur ka jetuar edhe babai i tij R.A., nëna e tij A.A.3.. Kurse H. i ka takuar një tokë në qytet,gjegjësishtë ngastrat kadastrale si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, e cila ngastër qysh nga momenti i zgjidhjes së bashkësisë familjare të

sipër përmendur ka kaluar në posedim të H.A., kurse pas vdekjes së H. në posedim të së njejtës janë fëmijët e ti njejtit. Pas vdekjes së H.A.1. pronën kontestuese të shënuar si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjyimi e kanë pasur në posedim N., N.1. dhe familja e tyre. Anjëherë nuk ka pasur ankesa në mes H.1. dhe H. në lidhje me mënyrën e ndarjes. Shtëpia e re e ndërtuar në paluejtshmërin si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi është ndërtuar pas luftes.

Me dëgjimin e dëshmitarës A.N., nga Shkupi Republika e Maqedonis, gjykata ka vërtetuar se bashkësin familjare në mes të H.A. dhe H.A.1. e ka zgjidhur babai tyre R.A. dhe me rastin e ndarjes së bashkësisë familjare në mes të H.A.1. dhe H.A. paluejtshmërin si në pikën II të dispozitivit babai tyre ia ka lënë H.A.1. ,kurse plauejtshmëria si në pikën I të dispozitivit babai i tyre ia ka lënë H.A. .Pas ndarjes së bashkësisë së sipër përmendur familjare ,prindërit e H.A. dhe H.A.1. ,kanë jetuar me H.A.. H.A.1. deri në vdekje ka jetuar në shtëpin që ka qenë e ndërtuar në vendin ku janë duke u ndërtuar banesat gjegjësishtë paluejtshmërin si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi. Kurse edhe pas vdekjes së H.A.1. në vendin ku janë duke u ndërtuar banesat gjegjësishtë paluejtshmërin si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi kanë jetuar fëmijët e H.A.1. Kurse H.A.1. dhe H.A. nuk kanë pasur asnjëherë probleme njëri me tjetrin. Kurse H.A. ka qenë i kënaqur me ndarjes e sipër përmendur dhe e njejtja ndarje është bërë në shtëpi dhe gojarishtë. Në posedim të paluejtshmërisë së në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi që nga ndarja e bashkësisës familjare ndërmjet H.A. dhe H.A.1. ka qenë H.A. deri në vdekje ,kurse pas vdekjes së H. në posedim të paluejtshmërisë së sipër përmendur si në pikën I janë fëmijët e H.A.

Me dëgjimin e dëshmitarit B.M. nga Ferizaji Rr’’...’’ nr... gjykata ka vërtetuar: H.A. dhe H.A.1. janë vëllezër që kishin jetuar së bashku në rrugën’’...’’, në Ferizaj deri në vitin 1975-76 .Kurse në vitin 1976 të sipër përmendur janë ndarë ashtu që H.A. ka shkuar për te jetuar në banes ,kurse H.A.1. ka vazhduar për të jetuar në rrugën ‘’...’’. Ndarjen e sipër përmendur të bashkësisë familjare në mes të H.A. dhe H.A.1. e kishte bërë babai tyre R.A.. Me rastin e ndarjes së bashkësisë së sipër përmendur familjare paluejtshmërin si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi R.A. i ka dhënë H.A.1. ,kurse H.A. ia kishte dhënë paluejtshmëria si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi. Ndarjen e bashkësisë familjare në mes të H.A. dhe H.A.1. e kishte bërë babai i të njejtëve R.A. ,kurse H.A. dhe H.A.1. kanë qenë të kënaqur me ndarjen e bashkësisë familjare që e ka bërë babai i tyre. H.A. nga momenti shkputjes së bashkësisë së sipër përmendur familjare ka jetuar në paluejtshmërinë kontestuese gjegjësishtë rrugën’’...’’ deri në vdekje ,kurse pas vdekjes së tij në të njejtën paluejtshmëri kanë vazhduar të jetojnë fëmijët e H.A.1. .Pas ndarjes së bashkësisë së sipër përmendur familjare prindërit e H.A. dhe H.A.1. kanë vazhduar të jetojnë me H.A.1. në rrugën ‘’...’’. Nga ndarja e bashkësisë së sipër përmendur familjare e deri në vdekje ka qenë në posedim të paluejtshmërisë si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi H.A. .Kurse pas vdekjes së H.A. në posedim të paluejtshmërisë si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi kanë qenë dhe janë fëmijët e H.A., gjegjësishtë familja e ngushtë e të njejtit.

Me dëgjimin e dëshmitarit S.A. nga Ferizaji rr''...''-banesat e ... gjykata ka vërtetuar :H.1. dhe H. kanë shkputur bashkësin familjare në mes të viteteve 70-ta dhe prej kohës kur ka ndollur ajo ndarje H. ka shkuar për të jetuar në banes , kurse H.1. ka mbetur për të jetuar në shtëpin që gjindej në rrugën''...'' së bashku me nënën e tij ,babain dhe familjen e tij ,ku në të njëjtin vend ka jetuar deri në vdekje. Kurse pas vdekjes së të njëjti në atë vend-paluejtshmërinë si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi kanë vazhduar të jetojnë Fëmijët e H.1. .Pas ndarjes së bashkësisë familjare H.1. dhe H. nuk janë bashkuar asnjëherë për të jetuar në një shtëpi.

Me dëgjimin e dëshmitarës N.H., nga Shtimja gjykata ka vërtetuar se në momentin e ndarjes së bashkësisë familjare në mes të H.A. dhe H.A.1. paluejtshmëria si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi i ka takuar gjegjësishtë i është dhënë H.A. nga babai tij ,kurse paluejtshmëria si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi i ka takuar gjegjësishtë i është dhënë H.A.1 dhe vajzave të R.A. e më pas të njëjtat pjesën e tyre ia kanë dhënë H.A.1. Prej vitit 1975 e derisa ka vdekur H.A.1. ka qenë në posedim të paluejtshmërisë si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.Kurse në posedim të paluejtshmërisë si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi ka qenë H. nga vitit 1975 e derisa ka vdekur ,kurse pas vdekjes së H. në posedim të paluejtshmërisë në fjalë janë fëmijët e H.A., ku e kanë të ndërtuar edhe shtëpin e tyre. H. dhe H.1. nuk kanë pasur mosmarrëveshje për këtë ndarje. Ndarjen e bashkësisë familjare në mes H. dhe H.1. e ka bërë babai i të njëjtëve në vitin 1975 ashtu që paluejtshmërinë si në pikën I ia ka lënë H. ,kurse paluejtshmërinë si në pikën II ia ka lënë H.1.Dhe nuk ka pasur mosmarrëveshje ndërmjet H.A. dhe H.A.1. në lidhje me ndarjen në fjalë.

Me dëgjimin e dëshmitarit Smajl Ajeti ,gykata ka vërtetuar : nga vitit 1980 e derisa ka vdekur H.A.1 e ka shfrytëzuar paluejtshmërinë si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, kur të njëjtin vend e kanë shfrytëzuar edhe fëmijët e H.A.1. Kurse paluejtshmërin si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi e ka blerë R.A. dhe pastaj ia ka dhënë H.A. Prej momentit kur janë ndarë H.1. dhe H., H.A. nuk ka shkuar për të jetuar në paluejtshmërin si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Me dëgjimin e dëshmitarit R.M. gjykata ka vërtetuar;Ndarja e bashkësisë familjare në mes të H. dhe H.1. ka ndollur në vitet e 70-ta dhe ndarjen e të njëjtës bashkësi e ka bërë babai i tyre.Në momentin e ndarjes së bashkësisë familjare të sipër përmendur babai H. dhe H.1. paluejtshmërinë si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi ia ka lënë H.A.1. ,kurse paluejtshmërinë si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi ia ka lënë H.A. H.A.1. paluejtshmërinë si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi e ka shfrytëzuar edhe nga momenti kur është zgjidhur bashkësia e sipër përmendur familjare e derisa ka vdekur.Kurse pas vdekjes të njëjtën e paluejtshmëri e kanë shfrytëzuar djemt e H.A.1.Kurse paluejtshmërinë si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi nga monenti i zgjidhjes së bashkësisë së sipër përmendur familjare e ka shfrytëzuar H.A. derisa ka vdekur ,kurse pas vdekjes së tij e kanë shfrytëzuar fëmijët e H.A. Pas zgjidhjes së bashkësisë së sipër përmendur familjare R.A. ka jetuar me H.A.1. derisa ka vdekur,në shtëpin e cila ka qenë ndërtuar në paluejtshmërinë si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi. H.A. nuk është kthyer për të jetuar në shtëpin që ka qenë e ndërtuar

në paluejtshmërinë si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe as që ka tentuar. H. me H.A.1. kanë pasur raporte të mira dhe të njejtit nuk kanë pasur mosmarrëveshje rreth ndarjes së bashkësisë familjare.

Me dëgjimin e dëshmitarit N.A.3. gjykata ka vërtetuar : se paluejtshmërinë si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi R.A. ia ka lënë H.A.1. diku në vitet e 70-ta .Kure paluejtshmërinë si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi R.A. ia ka lënë H.A. H.A.1. paluejtshmërinë si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi e ka shfrytëzuar derisa ka vdekur kurse pas vdekjes së H.A.1. të njejtën paluejtshmëri e kanë shfrytëzuar fëmijët e H.A.1. H.dhe H.1. nuk kanë pasur mosmarrëveshje në lidhje me paluejtshmërinë si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi .

Me leximin e aktvdekjes së hartuar me datë 28.04.1993,në emër të R.A. gjykata ka vërtetuar se R.A., nga babai M. ishte i lindur në vitin 1915 dhe kishte vdekur me datë 16.09.1986 në Ferizaj,me adresë të fundit të vendbanimit rruga "...",kurse si trashëgimtar ishin shënuar në këtë aktvdekje e ndjera A.A.3, R.I., H.A.1., i ndjeri H.A., A.N., N.H., K.A..

Me leximin e certifatës së vdekjes së datës 28.04.1993 ,me numër 41 gjykata ka vërtetuar se R.A. ishte i lindur me datë ..., nga babai M.A. dhe nëna A.I., kurse kishte vdekur me datë 16.09.1986 .

Me leximin e aktvendimit për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore të të ndjerit R.A., nr. T.nr.37/93 ,i datës 21.05.1993 gjykata ka vërtetuar se me këtë aktvendim trashëgimtar i ngastrës kadastrale nr.1894 ,e cila gjindej në vendin e quajtur ‘...’ ,me kulturë shtëpi dhe oborr ishte shpallur H.A.1. nga Ferizaji.

Gjykata pasi vlerësoj provat e administruara e ka aprovuar si të bazuar pjesërishtë kërkesëpadin e paditësve edhe për përpaluejtshmërinë të cekur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi gjegjësishtë ngastrën kadastrale ... ZK Ferizaj edhe atë nga këto arsye:

Me dëgjimin e dëshmitarëve F.A.2., me numër personal të letërnjoftimit ..., A.N. nga Shkupi Republika e Maqedonisë së Veriut-Lagjja Aerodrom, me numër personal ..., B.M. nga Ferizaji ,Rr’...”,nr..., me numër personal ..., S.A., nga Ferizaji ,rr’...’-banesa e ...,me numër personal ..., N.H. nga Shtimja ,me numër personal ..., S.A.1. me numër personal ..., R.M., me numër personal të letërnjoftimit ..., N.A.3. ,me numër personal të letërnjoftimit ... gjykata ka vërtetuar se para vitit 1975-76 H.A. dhe H.A.1. kishin jetuar në një bashkësi familjare së bashku me prindërit e tyre R.A. dhe A.A.3. dhe aty rreth viteve 1975-76 ishte zgjidhur bashkësia e sipër përmendur familjare nga babai tyre R.A. dhe me rastin e zgjidhjes së kësaj bashkësie familjare babai i H.A. dhe H.A.1., R.A. paluejtshmërinë si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi ia kishte lënë-dhënë H.A. ,i cili e kishte poseduar të njejtën nga momenti zgjidhjes së kësaj bashkësie familjare e derisa kishte vdekur ,kurse

pas vdekjes së H.A. në posedim të së njejtës paluejtshmëri ishin fëmijët e tij dhe bashkëshortja Z.A. pa u penguar nga askush.

Andaj meqë paraardhësi i paditësve nga vitit 1975-76 ishte në posedim të paluejtshmërisë - ngastrën kadastrale ... ZK Ferizaj deri me datën 04.10.1983 ,kurse tani paditësit ishin në posedim të paluejtshmërisë në fjalë nga momenti vdekjes së paraardhësit të tyre H.A. 04.10.1983 e deri tani 2021 rezulton se paditësit pronësinë në paluejtshmërinë kontestuese e kanë fituar me parashkrim fitues në bazë të nenin 28 paragrafet 4,5 të Ligjit mbi Mardhënjet Themelore Juridike –Pronësore ,neni 30 i të njejtë ligj në fuqi nga data 30.01.1980 deri me datë 19.08.2009 ,në lidhje me nenin 40 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore në fuqi nga data 19.08.2009.E po ashtu paditësit e kanë fituar pronësinë për ngastrën kadastrale ... ZK Ferizaj edhe në bazë të trashëgimisë nga i ndjeri H.A. [neni 2 i Ligjit të Trashëgimis i datës 30.12.1974 i KSAK-së] ,e cila paluejtshmëri në fjalë i kishte takuar gjegjësishtë i ishte dhënë nga babai tij me rastin e zgjidhjes së bashkësisë së sipër përmendur familjare,për të cilën ndarje ishte pajtuar edhe H.A.1. , e cila ndarje e bashkësisë familjare edhe ishte zbatuar ,sepse H.A. mbi bazën e të njejtës e kishte marrur në posedim ngastrën kadastrale ... ZK Ferizaj,e që në posedim të së njejtës ishin edhe paditësit.

Gjykata pasi vlerësoj provat e administruara e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesëpadin e paditësve për përpaluejtshmërin të cekur si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgykimi gjegjësishtë kërkesëpadin me të cilën kanë kërkuar që tu njihet e drejta e pronësisë në ½ pjesë ideale [secili në pjesën ideale prej 1/10 të sajë]të ngastrës kadastrale P-... në sipërfaqe prej 306 m2 ,ZK Ferizaj e cila pas bashkimit edhe me shumë ngastra tjera është bërë pjesë e ngastrës kadastrale nr... ZK Ferizaj ,e regjistruar në emër të të paditurës “...”,si dhe të anulohet kontrata për bashkëinvestim :LRP.nr.9581/2017 ,nr.Ref.nr.3550/2017 në pjesën e cila ka të bëjë me pjesën ideale prej ½ të ngastrës kadastrale P-... në sipërfaqe prej 306 m2 ZK Ferizaj edhe atë nga këto arsye:

Me dëgjimin e dëshmitarëve F.A.1, me numër personal të letërnjoftimit ..., A.N. ,nga Shkupi Republika e Maqedonisë së Veriut-Lagjja Aerodrom,me numër personal ..., B.M. nga Ferizaji ,Rr’’...’’, nr..., me numër personal ..., S.A. ,nga Ferizaji ,rr’’...’’-banesa e ...,me numër personal ..., N.H. nga Shtimja ,me numër personal ..., S.A.1.,me numër personal ..., R.M. me numër personal të letërnjoftimit ..., N.A.3. ,me numër personal të letërnjoftimit ... gjykata ka vërtetuar se para vitit 1975-76 H.A. dhe H.A.1. kishin jetuar në një bashkësi familjare së bashku me prindërit e tyre R.A. dhe A.A. dhe aty rreth viteve 1975-76 ishte zgjidhur bashkësia e sipër përmendur familjare ,nga babai tyre R.A. dhe rastin e zgjidhjes së kësaj bashkësie familjare babai i H.A. dhe H.A.1. paluejtshmërin si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgykimi ia kishte lënë-dhënë H.A.1. ,për të cilën ndarje ishte pajtuar H.A. ,kurse H.A.1. e kishte poseduar të njejtën nga momenti zgjidhjes së kësaj bashkësie familjare e derisa kishte vdekur 25.12.1996 ,kurse pas vdekjes së H.A. në posedim të së njejtës paluejtshmëri ishin fëmijët e tij tani të paditurit pa u penguar nga askush.

Andaj meqë paraardhësi i të paditurve nga vitit 1975-76 ishte në posedim të paluejtshmërisë – si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi deri me datën 25.12.1996 ,kurse tani të paditurit ishin në posedim të paluejtshmërisë në fjalë nga momenti vdekjes së paraardhësit të tyre H.A.1. 25.12.1996 e deri tani 2021 rezulton se të paditurit pronësinë në paluejtshmerinë kontestuese si në pikën II e kanë fituar me parashkrim fitues në bazë të nenin 28 paragrafet 4,5 të Ligjit mbi mardhënje Themelore Juridike –Pronësore ,neni 30 i të njejtë ligj në fuqi nga data 30.01.1980 deri me datë 19.08.2009 ,në lidhje me nenin 40 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore në fuqi nga data 19.08.2009.E po ashtu të paditurit e kanë fituar pronësinë për paluejtshmerinë kontestuese si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi edhe në bazë të trashëgimisë nga i ndjeri H.A.1. [neni 2 i Ligjit të Trashëgimis i datës 30.12.1974 i KSAK-së] ,të cilit paluejtshmeria në fjalë i kishin takuar me rastin e zgjidhjes së bashkësisë së sipër përmendur familjare e cila ndarjes e bashkësisë familjare edhe ishte zbatuar ,sepse H.A.1. mbi bazën e të njejtës e kishte marrur në posedim paluejtshmerin si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi ,e që në posedim të së njejtës ishin edhe të paditurit.

Përveq kësaj të paditurit B.A., N.A., N.A.1. e kanë fituar pronësinë në paluejtshmerinë si në pikën II të dispozitivit edhe në bazë të nenit 28 paragrafi 2 të Ligjit mbi Mardhënjet Themelore Juridiko Pronësore i Republikës Federative të Jugosllavisë ,nr.827,i datës 30 Janar 1980 ,në lidhje me nenin 28 paragrafi 1 i Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtata Tjera Sendore i Kosovës,sepse të njejtit nga momenti i rregullimit të trashëgimis me aktvendimin e datës 20.06.2007 kanë qenë në posedim pronësorë të regjistruar të paluejtshmërisë si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Përveq kësaj paditësit e kanë humbur mundësin ligjore që të kërkojnë paluejtshmerinë si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi sepse në bazë të nenit 125 të Ligjit mbi Trashëgiminë i Krahines Socialiste Autonome të Kosovës i datës 30.12.1974,nr.711-3,i publikuar në Gazetën Zyrtare të KSAK-së me numër 43 ,faqe 1771 ishte paraparë se e drejta për të kërkuar pasurinë trashëgimore si trashëgimtar i trashëgimlënësit parashkruhet brenda afatit prej 10 viteve duke llogaritur nga vdekja e trashëgimlënësit,ndaj poseduesit me mirëbesim ,kurse ndaj poseduesit me keqbesim brenda afatit prej 20 vite .Kurse në rastin konkret nga vdekja e R.A. 10.09.1986 e deri me datën e ushtrimit të padis 10.11.2017 kanë kaluar më shumë se 30 vite.

Kurse rregulli i sipër përmendur ligjorë është paraparë edhe me nenin 138 të Ligjit për Trashëgimin i Kosovës nr.2004/26,i datës 04.02.2005,i publikuar me Rregulloren e Unmikut 2005/7.

Gjykata ka vendosur si në pikën III dhe V të dispozitivit të këtij aktgjykimi ,sepse paditësit kanë pasur pjesërishtë sukses në procesin kontestimorë ndaj të paditurve B.A., nga Ferizaji, N.A. nga Ferizaji, N.A.1. nga Ferizaji , M.D. nga Ferizaji, N.A.2., nga Ferizaji, E.A., nga Ferizaji, F.A. nga Ferizaji,sepse pjesërishtë është aprovuar kërkesëpadia edhe atë për paluejtshmerin si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi,bazuar në nenin 452.2 të LPK-së.

Gjykata i ka detyruar paditësit që të paditurës ‘’...’’ SH.P.K,me seli në Ferizaj, Rr’’...’’ tia kompenzojnë shpenzimet e procedurës ,sepse paditësit në raport me këtë të paditur e kanë humbur në tërësi kontestin gjyqësore ,ky vendim i gjykatës bazohet në nenin 452.1 të LPK-së.

Vendimi për taksën gjyqësore për padi është bazuar në udhëzimin administrativ për unifikimin e taksave gjyqësore.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Me datë 27.09.2021

Gjyqtari

Burim Emërllahu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund të ushtrohet ankesa, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, përmes kësaj gjykate.